



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:061548

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06071105

**C.nr.191/21**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Hatixhe Begaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësit A.K.nga fshati B., Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Haki Kryeziu nga Malisheva, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shujtave dhe pagës jubilarë, jashtë seancës gjyqësore, me datën 21.08.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K.nga fshati B., Komuna e Malishevës, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit që t'ia paguaj paditësit **A.K.:**

- në emër të kompensimit të shujtave për periudhën nga data 31.03.2020 – 21.11.2022 gjithsej 331 ditë pune t'ia paguaj nga dy euro në ditë, në shumën prej **662.00 euro**,
- në emër të një page jubilarë të përlllogaritur për 10 vite përvojës të punës prej 50% shumën prej **229.50 euro**;

Në total shumën e përgjithshme prej **891.50 euro**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 31.03.2021, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**II. REFUZHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar, konkretisht shuma prej 20.50 euro në emër të pagës jubilarë.

**III. DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

## A r s y e t i m

Paditësi Arlind Kryeziu nga fshati B., Komuna e Malishevës përmes të autorizuarit të tij Av. Haki Kryeziu nga Malisheva, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave dhe pagës jubilarë sipas padisë paditësi është i punësuar në SHMP “Lasgush Poradeci” në K., Komuna e Malishevës, me kontratën kolektive është paraparë që të punësuarve në marrëdhënie të punës primare u takon ushqimi ditor në vlerë prej 2 euro në ditë të punës, poashtu e paditura nuk i ka paguar paditësit një pagë jubilarë për 10 vite të përvojës së punës, gjykatës i ka propozuar të aprovohet padia e paditësve si e bazuar

I autorizuari i paditësit përmes parashtrësës së datës 24.05.2024 ka bërë precizimin e padisë duke i bashkangjitur edhe vërtetimet e punës, ashtu që paditësi për periudhën 2020-2022 ka gjithsejtë 331 ditë pune të përlogaritur sipas shujtës ditore prej 2 euro, t’ia paguaj shumën prej 662 euro, në emër të pagës jubilarë prej 50% për 10 vite përvojë pune shumën prej 250 euro, prej ditës së paraqitjes së padisë, deri në pagesën përfundimtare me kamatë prej 8%.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për parashtrimin e padisë t’ia paguaj shumën prej 104.00 euro, për taksë shumën prej 20 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar duke e kontestuar padinë e paditësit, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi pasi që palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me dt; 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate, po ashtu, MAPL ka bërë njoftim për kryetaret e Komunave me dt: 22.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT për mungesë të bazës ligjore të kësaj kontrate kolektive, meqenëse kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT dhe ka qenë e lidhur nga kjo ministri komuna e Malishevës - DKAE lidhur me këtë çështje kontestuese nuk kanë legjitimitet të palës aktive në këtë procedurë, por këtë legjitimitet tani e ka MASHT, i propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë dega Malishevë që ta refuzon padinë e paditësve si të pa bazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës – MASHT, poashtu sipas përgjigjes në padi, e paditura ka theksuar se borxhi është parashkruar, gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: Vërtetimin mbi përvojën e punës dhe ditët e punë nr.1/29 të datës 12.12.2022 dhe listën e pagave.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa e aprovoj në tërësi për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, ndërsa kontestuese rezulton të jetë drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, dhe pagës jubilarë për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, gjë për cilën e paditura e ka pohuar këtë të drejtë të tyre, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 35 par.7 në të cilën përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, ndërsa në pikën 8 lidhur me të drejtën në kompenzimin e pagave jubilarë përcaktohet se *“Punëtorët ( anëtarët e SBASHK-ut) për vitet jubilarë të punësimit përfitojnë çmimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë dhe atë për 10 vite përvojë të punës në vlerën prej 50% të një page bazë, për 20 vite përvojë të punës në vlerë prej 75% të një page bazë, për 30 vite përvojë pune në vlerë të një page bazë dhe 40 vite të përvojës së punës në vlerën prej 150% të një page bazë, ndërsa shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse”*kjo gjykatë vlerëson se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore dhe një page jubilarë për ditët e pranisë në punë përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, por gjykata pretendimet e e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësi padinë e ka parashtruar brenda periudhës 3 vjeqare dhe në periudhën në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 22.01.2021, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja padinë e ka parashtruar në të njëjtën periudhë që përkon me kontratën kolektive të vitit 2021, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se *“Të gjitha kërkesat nga*

*marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”,*

Pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”,* ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”,* ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësja sipas padisë kërkonë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata kishte parasysh edhe pretendimet tjera të të paditurës mirëpo vlerëson se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe.

Gjykata përmes listës së pagave ka vërtetuar se paditësi ka pagën bazë 459.00 euro, andaj 50% e pagës bazë i bije të jetë shuma prej 229.50 euro, ndaj sipas listës së pagave paga bazë 459.00 € x 50% e pagës bazë = 229.50 €, andaj gjykata refuzoj shumën prej 20.50 euro mbi këtë bazë dhe vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (31.03.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditësve t’ia paguajë dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152, dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 dhe 8 e Kontratës Kolektive Arsimit.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË**

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.191/21 me datën 21.08.2024

Gj y q t a r j a  
Hatixhe Begaj

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.